

VENDIM
Nr. 36, datë 4.3.2015

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “DEVOLL HIDROPOWER” SHA NË
AKTIVITETIN E FURNIZUESIT TË KUALIFIKUAR TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 3, pika 31; 8, pika 2, germa “a”; 9 dhe nenit 45, pika 4; dhe 48, pika 2, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa “f”; 5, pika 1, germa “f”; 13 dhe 14, pika 1, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 4.3.2015, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Devoll Hidropower” sh.a., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike, konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Devoll Hidropower” sh.a., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshme dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar tërësisht.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar tërësisht.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar tërësisht.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.9, gerrat “a”, “b”, “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Devoll Hidropower” sh.a. në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti